Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1006

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE N.N.P "ATC Com" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i sistemit të ngrohjes qëndrore të objektit të administratës komunale" me numër të prokurimit 652-23-10079-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Kaçanikut, më 13/02/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e N.N.P "ATC Com" SH.P.K. me nr. 2023/1006, e datës 11/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i sistemit të ngrohjes qëndrore të objektit të administratës Komunale", me numër të prokurimit 652-23-10079-5-2-1 të KK Kaçanik.

2. Anulohet vendimi i Autoriteti Kontraktues (AK) për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit "Rregullimi i sistemit të ngrohjes qëndrore të objektit të administratës Komunale", me numër të prokurimit 652-23-10079-5-2-1, aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

3. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.09.2023, Komuna e Kaçanikut në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i sistemit të ngrohjes qëndrore të objektit të administratës Komunale", me numër të prokurimit 652-23-10079-5-2-1.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e

parashikuar e kontratës: 189,800.00€.

Me 29.11.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për dhënie të kontratës, të cilën AK e ka refuzuar me datën 04. 12. 2023.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së OE ankues e N.N.P "ATC Com" SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2023/1006 e datës 11.12.2023, për aktivitetin e sipërcituar.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit N.N.P "ATC Com" SH.P.K

Bazuar ne nenin 108/A të LPP-se citojmë: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit. Respektivisht bazuar Rregullore Nr.001 /2022 për Prokurimin Publik ne nenin 60.1 pika a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Bazuar ne Ligjin nr. 03/L-064 Ligji për festat zyrtare në Republikën e Kosovës Neni 2 Festat zyrtare në Republikën e Kosovës janë të përcaktuara festat zyrtare janë: a) Viti i Ri-1 dhe 2 janari; b) Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 17 Shkurti; c) Dita e Kushtetutës b) së Republikës së Kosovës, 9 Prilli; d) Dita Ndërkombëtare e Punës, 1 Maji; e) Dita e Evropës, 9 Maji; c). f) Bajrami i Madh, dita e parë; g) Bajrami i Vogël, dita e parë; h) Krishtlindjet Katolike, 25 dhjetor; d) i) Krishtlindjet Ortodokse, 7 janar; j) Pashkët Katolike, E hëna e Pashkëve; k) Pashkët Ortodokse, e hëna e Pashkëve. Pretendimi: Dëshmia (Për stafin profesional Lista e vërtetuar e punëtoreve, si dhe për ing Diplomat përkatëse, CV ja, përvoja e punës, kontrata e punës valide- (kopje), apo Marrëveshje, dëshmia për përvojën e punës - Vendimi mbi caktimin menaxherit për këtë projekt e nënshkruar dhe vulosur nga OE). Përgjigje ne Pretendimin: OE i propozuar për Kontratë ofron dëshminë për Stafin: Kërkesa:. Stafi profesional - Një Ing. te diplomuar i Makinerisë së paku 5 vite përvojë pune. Dëshmia: Për stafin profesional Lista e vërtetuar e punëtoreve, si dhe për ing Diplomat përkatëse, CV-ja, përvoja e punës, kontrata e punës valide. OE ofron Listën e Stafit Profesional dhe atë Isa Bajraktari Ing. i Makinerisë dhe Avdyl Lajqi Ing, i Elektrosë. Ku ofron dëshmitë respektivisht Kontratë me dt. 13.10.2023 për ketë Projekt. OE ofron dëshminë për përvojën e punës për Ing. dhe Vendimin e menaxherit. OE ka ofru dëshminë për Vlerësimin e rriskut nga një Kompani e licencuar për se paku. 6 punëtorë te certifikuar për siguri dhe shëndet në punë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N.P "ATC Com" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

AK KK Kaçanik ne aktivitetin e prokurimit ka shpërblyer me kontrate OE Termo-Solar me çmim 176 362.25 €. OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i përmbush kriteret e kërkuara te Njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit pasi qe i kemi paraqitur arsyet se pse është i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontrate, por AK Komuna Kaçanik na refuzon kërkesën për rishqyrtim si te pas afatshme apo te palejuar me arsyetimin se ne si OE e kemi bere kërkesën për rishqyrtim me date 29.11.2023, e qe data 28.11.2023 ka qene pushim apo feste zyrtare, qe është njoftim edhe nga MPB e Republikës se Kosovës. Pra, arsyetimi i AK-se ka qene se me date 28.11.2023 ka qene afati i fundit për kërkesë për rishqyrtim e qe me date 27.11.2023, ka njoftim nga MPB qe thotë se me date 28.11.2023 është Dite pushimi për shkak te 28 nëntorit – Ditës se Flamurit kombëtare...Citim teksti: Te nderuar nëpunës te administratës publike. Duke u bazuar ne Ligjin nr.03/L-064 për Festat Zyrtare ne Republikën e Kosovës, ju njoftojmë se për Ndere te Festes se 28 Nëntorit – Ditës se Flamurit, dita e marte 28 nëntor, do te jete dite pushimi.

Paragrafi 2 i nenit 5 (Afatet Kohore) thotë (citim): Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundi te afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditë ne parë të punës pas kësaj. Pasi qe data 28 nëntor ka qene dite feste , sipas paragrafit 2 te nenit 5 automatikisht kuptohet se zgjatet afati i ankesën për ditën tjetër te punës, e qe ne rastin konkret është data 29.11.2023., pra edhe paragrafi 1 i nenit 5 te LPP-se thotë Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune.

Pra, ky njoftim i MPB na sqaron se data 28 nëntori është dite pushimi dhe nuk ka punuar administrata publike, e ne rastin ne fjale Komuna e Kaçanikut, kurse po ky AK-Komuna e Kaçanikut na e refuzon si te palejuar kërkesën për rishqyrtim për shkak se nuk është bere ankesa ditën e fundit apo me 28 nëntor. AK-Kuvendi i Komunës Kaçanik e ka refuzuar ankesën duke u bazuar ne nenin 60.1 te Rregullores për Prokurim Publik 01/2022, poashtu bazuar ne Ligjin 03/L-064 Ligji për Festat Zyrtare, te cilin vendim ne e kundërshtojmë pikërisht bazuar ne Njoftimin e MPB-se, bazuar ne ligjin e Festave zyrtare.OE i rekomanduar dëshmohet se nuk i plotëson kriteret e kontratës sipas kriterit te Kapaciteti teknik dhe profesional i Njoftimit për Kontrate dhe Dosjes se tenderit është kërkuar. Ne si OE ofertues i kemi paraqitur edhe ne kërkesën për rishqyrtim, bazuar ne provat qe i kemi marr ne qasjen qe kemi pasur, qe e kemi shkruar edhe ne kërkesën për rishqyrtim te bere ne AK, citim: Ne pas marrjes se dokumentacionit pranë zyrës se Prokurimit ne Komunën e Kaçanikut , kemi analizuar materialin dhe kemi ardhur ne përfundim se Operatori ekonomik i shpallur fitues nuk i ka plotësu disa pika te kritereve te caktuara nga A.K. e ato do ti shtjellojmë mëposhtëm një nga një: 1.0 Stafi profesional - Një Ing. te diplomuar i Makinerisë se paku 5 vite përvojë pune. Dëshmia (Për stafin profesional Lista e vërtetuar e punëtoreve, si dhe për ing Diplomat përkatëse, CVja, përvoja e punës, kontrata e punës valide- (kopje), apo Marrëveshje, dëshmia për përvojën e punës - Vendimi mbi caktimin menaxherit për këtë project e nënshkruar dhe vulosur nga OE). Ku bazuar ne këtë kriter te DT-se lidhur me Inginierin e diplomuar te makinerisë, gjate qasjes qe kemi pasur e kemi vërtetuar se: Te kriteri i kërkuar i DT-se dhe NJK-se: Një Ing. te diplomuar i Makinerisë se paku 5 vite përvojë pune. Dëshmia (Për stafin professional Lista e vërtetuar e punëtoreve, si dhe për ing Diplomat përkatëse, CV-ja, përvoja e punës, kontrata e punës valide- (kopje), apo Marrëveshje, dëshmia për përvojën e punës - Vendimi mbi caktimin menaxherit për këtë Project e nënshkruar dhe vulosur nga OE).

Nga kriteri i kërkuar i DT-se shihet se: Inxhinieri i ofruar nga ana e OE fitues z. Isa Bajraktari sipas CV-se qe e ka ofruar ne dosjen e tenderit shihet se te gjithë përvojën e tij e ka ne institucione arsimore prej vitit 1996 e deri me tani ne vitin 2023 ku edhe e ka te bashkangjitur vërtetimin nga IAAP "Skënder Luarasi" nga Suhareka , gjithashtu Referenca e lëshuar nga O.E. TERMOSOLAR ENGINERING SHPK me date 01.09.2023, e njëjta nuk mund te qëndron dhe nuk munde te jete valide pasi qe e njëjta nuk është e përshkruar ne CV. Udhëzuesi operativ i KRPP-se e sqaron shume qarte se nëse CV e dorëzuar nuk përmbush kriteret e kërkuara OE është i papërgjegjshëm, citim sipas Udhëzuesit te Prokurimit CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Andaj, CV e dorëzuar nuk është konform kriterit te Dosjes, dhe kjo e bën ofertën e papërgjegjshme sipas Udhëzuesit....Te kriteri i kërkuar i DT-se dhe NJK-se: Se paku Një elektricistë te çertifikuar - (kërkesa është për punëtore te certifikuar si elektricist ose punëtor me drejtim ne shkolle te mesme teknik i elektros). Nga kriteri i kërkuar i dosjes se tenderit është kërkuar një elektricist i certifikuar, e nuk është kërkuar inxhinjer i elektros siç e ka dorëzuar O.E. fitues. Andaj, OE i rekomanduar nuk e plotëson këtë kriter O.E. fitues, pasi qe OE i njëjtë nuk e ka dorëzuar asnjë punëtorë qe është elektricist i certifikuar. Pra, OE i rekomanduar për kriterin e kërkuar Një elektricistë te çertifikuar e ka dorëzuar, Inxhinier i elektros i cili nuk e plotëson kriterin e kërkuar te dosjes, dhe kjo e bën ofertën e tij te papërgjegjshme. Pra, me këtë kriter OE i rekomanduar nuk e plotëson këtë kriter. Te kriteri i kërkuar i DT-se dhe NJK-se: Vlerësimin e rriskut nga një Kompani e licencuar për se paku 6 punëtore te certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. Dëshmia (Raportin e Vlerësimit të rriskut valid); OE i rekomanduar për kontrate, nuk i ka ngarkuar certifikatat e punëtoreve mirëpo nuk e ka ngarkuar raportin e vlerësimit te rriskut për kompaninë. Sipas qasjes qe kemi pasur rezulton se AK e ka kërkuar si sqarim shtese gjate fazës se vlerësimit dhe kjo e dëshmon se OE nuk e ka dorëzuar ne dosje, por e ka bashkangjitur ne fazën e vlerësimit me informata shtese. Mendoj se kjo e bën te papërgjegjshme OE e rekomanduar për kontrate.

Poashtu, edhe te kriteret e FDT-se, qe kërkohen para dhënies se kontratës apo vetëm për OE e rekomanduar për kontrate, nga qasja qe kemi marr nuk e kemi hasur askund vërtetimin e kërkuar te FDT-se siç kërkohet te kriteret e DT-se dhe NJK-se: Dokument nga Organi komunal në vendin e themelimit të OE se nuk ka obligime ndaj Komunës. 4. Dokument nga Gjykata kompetente se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë (te mos jetë më i vjetër se gjashte muaj nga data e dorëzimit te tenderit vetëm për fituesin.). Gjithashtu me duhet ta ceki se edhe dy dokumentet plotësuese qe dorëzohen për fituesin nuk i kam pare ne dosje (te njëjtat ndoshta edhe janë ofruar ne mënyrë fizike, mirëpo ne dosje te lendes te cilën e kam marr pranë A.K. nuk gjinden. Pra, kriteret e përcaktuara ne dosjen e tenderit u jep te drejte te gjithë OE-ve te marrin pjese, dhe te gjithë OE duhet te jene te barabarte para atyre kritereve. Paragrafi 4 i Nenit 65 i LPP-se e sqaron shume qarte se OE për te qene i përshtatshëm për tu rekomanduar për kontrate duhet ti plotëson kriteret e kërkuara, si ATK-se, Gjykatës etj etj. Ne si OE gjate qasjes qe kemi pasur nuk e kemi hasur ne kriteret e dosjes.

Pra, nga pretendimet tona qe i kemi sqaruar me larte rezulton se AK e ka rekomanduar për kontrate një OE te papërgjegjshëm, i cili OE duhet te elimonohet e jo te rekomandohet, pasi qe kriteret e FDT-se dhe NJK-se, kane qene te qarta dhe nëse kërkohet Punëtor i Certifikuar, duhet ta dëshmon certifikatën, e jo te paraqet dokument apo diplome qe nuk ndërlidhet me kriteret e DT-se, poashtu edhe Ing makinerisë sipas CV se bashkangjitur nuk i plotëson kriteret e kërkuara te dosjes, poashtu edhe te Vlerësimi i riskut është kërkuar shume i qarte, kurse AK nuk i ka respektuar kriteret e veta te kërkuara dhe ne fund tek vërtetimet qe kërkohen vetëm për fituesin para dhënies se ofertës. Paragrafi 1 dhe 2 i nenit 7 te LPP-se (Barazia ne trajtim/jo diskriminimi)

e sqaron shume qarte se OE duhet te trajtohen te barabarte: 1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Ne do të shqyrtojmë të gjitha rrugët tjera ligjore të cilën e mbrojnë te drejtën tonë pasi ne kemi te drejtë duke marrë hapa për mbrojtje në institucionet të larta juridike, të i drejtohemi organeve te tjera dhe Gjykatës Komerciale dhe të gjitha mekanizmave ligjor.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 13.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1006/23 ndërsa me datë 15.12.2024 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK*".

Konstatimet e ekspertes shqyrtuese lidhur me ankesën Nr. 1006/23 të operatorit ekonomik N.N.P "ATC Com" SH.P.K

*Konstatimi i parë (I):*Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në DT ka kërkuar: III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 2.Stafi profesional - 2.Stafi profesional - Një Ing. te diplomuar i Makinerisë se paku 5 vite përvojë pune. Listën e punëtoreve prej se paku - Se paku Një termoinstalues te certifikuar (Instalues të nxemjes qëndrore) - Se paku një elektricistë te certifikuar. 3. Vlerësimin e rriskut nga një Kompani e licencuar për se paku 6 punëtore te certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. 4. Mjetet e kompanisë për lëmin përkatëse; a) - Kamionete së Paku një, makinë për salldim te gypave se paku një etj. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2.Per stafin profesional Lista e vërtetuar e punëtoreve, si dhe për inxh. Diplomat përkatëse, CV-ja, përvoja e punës, kontrata e punës valide-(kopje), apo Marrëveshje, dëshmia për përvojën e punës - Vendimi mbi caktimin e menaxherit për ketë Project e nënshkruar dhe vulosur nga OE. 3. Raportin e Vlerësimit të rriskut valid; 4. Për mjete e punës Një Liste e vërtetuar nga OE, për mjetet qe i nënshtrohen regjistrimit libreza - kopje, apo marrëveshje pre huazim. Në ofertën e OE të rekomanduar në e-prokurim, lidhur me inxhinierin e Makinerisë, OE i rekomanduar posedon inxhinierin e makinerisë me përvojë pune mbi 5 vite, kurse sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me referencën e bashkangjitur, sqaroj se, nuk është e përfshirë në CV, mirëpo mund edhe të mos merret fare, për faktin se nga AK në DT nuk është kërkuar referenca, por vetëm përvoja e punës pa u cekur fare më tepër, të cilën OE i rekomanduar e përmbushë me vërtetimin e bashkangjitur. Andaj pretendimi i parë i OE ankues kundër OE të rekomanduarit nuk gjendet i qëndrueshëm.

Konstatimi i dytë (II): Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me elektricistin e çertifikuar, OE i rekomanduar në ofertë ka të bashkangjitur dokumentet si Diploma e noterizuar dhe CV për inxhinierin e diplomuar në fakultetin teknik, sesioni i elektroteknikës, drejtimi elektroenergjetikë, kurse sa i përket çeritifikatës, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK ka vlerësuar se diploma është me e avancuar se sa çeritfikata, marrë parasysh çmimin e ofruar, duke respektuar nenin 1 dhe 6 të LPP-së. Andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Konstatimi i tretë (III): Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me raportin e vlerësimit të riskut, në ofertën e OE të rekomanduar gjenden certifikatat e punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë mbi 6, mirëpo raportin nga a njëjta kompani e cila ka certifikuar punëtorët është e ofruar pas kërkesës për sqarim nga AK, e cila konsideroj se mund të merret e mirëqenë, për faktin se data e raportit është para publikimit të njoftimit për kontratë, po ashtu është kompania e njëjtë e cila ka certifikuar punëtorët, dhe si e tillë AK ka vepruar konform nenit 72 të LPP-së. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Konstatimi i katërt (IV): Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me dokumentin e lëshuar nga Komuna, në e-prokurim janë të bashkangjitura dy vërtetimet nga komuna për operatorët në konzorcium, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar. Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, ankesa e OE ankues gjendet pjesërisht e bazuar, mirëpo meqenëse nuk ndryshon rezultatin përfundimtar, andaj rekomandoj të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga ekspertja shqyrtuese, ndërsa Operatori ekonomik nuk është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda kthehet në ri-vlerësim. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit nuk është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK lëndën duhet ta kthej në ri-vlerësim dhe të kërkoj sqarime shtesë konform rekomandimeve të dhëna nga Paneli shqyrtues si më poshtë.

Vlenë të potencohet fakti se mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij nuk e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret në disa pika, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje, e që në rastin konkret nuk është i bazuar në prova dhe argumente. Andaj, rrjedhimisht PSH do ta elaboroj vetëm pikat ankimore 2

dhe 3 të radhitura sikur në ekspertizë dhe të cilat nuk kanë gjetur mbështetje të plotë për dallim nga raporti i ekspertizës.

Lidhur me pretendimin ankimore 2, për elektricistin e çertifikuar, OE i rekomanduar në ofertë ka të bashkangjitur dokumentet si Diploma e noterizuar dhe CV për inxhinierin e diplomuar në fakultetin teknik, sesioni i elektroteknikës, drejtimi elektroenergjetikë, kurse sa i përket çeritifikatës, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK ka vlerësuar se diploma është me e avancuar se sa çeritfikata, paneli shqyrtues nuk e mbështet këtë arsyetim të ekspertit shqyrtues deri sa kjo mos të vërtetohet nga ana e AK rreth kësaj çështje tek organet komepetente qoftë edhe me profesionist të fushëse, sepse elektricist i çertifikuar është një profesion/zanat me çrast i lëshohet një personi i cili ka përfunduar trajnimin e caktuar, ndërsa inxhinier në këtë rast i elektros është një titull akademik, andaj, AK duhet të komunikojë me institucionet kompetente se inxhineri i elektros a e mbulon edhe fushën e një elektricisti të çertifikuar. Nisur nga ky fakt për të vërtetuar se vlerësimi i ofertave është bërë konform nenit 59 të LPP dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit, Paneli shqyrtues është detyruar ta marrë këtë vendim për shkak se eksperti shqyrtues nuk e ka arsyetuar dhe nuk e ka argumentuar këtë, .

Lidhur me pretendimin ankimore 3 me raportin e vlerësimit të riskut, në ofertën e OE të rekomanduar gjenden certifikatat e punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë mbi 6, mirëpo raportin nga a njëjta kompani e cila ka certifikuar punëtorët është e ofruar pas kërkesës për sqarim nga AK, e cila konsideroj se mund të merret e mirëqenë, për faktin se data e raportit është para publikimit të njoftimit për kontratë, po ashtu është kompania e njëjtë e cila ka certifikuar punëtorët, dhe si e tillë AK ka vepruar konform nenit 72 të LPP-së. Paneli shqyrtues nuk pajtohet me ekspertin shqyrtues sepse nuk është vërtetuar se sqarimet e kërkuara nga AK janë konform nenit 72 të LPP, ngase sipas këtij neni tek paragrafi 3, citon "*Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*". Andaj, nisuar nga fakti se OE i rekomanduar nuk e ka paraqitur raportin e kërkuar me DT në ofertën e tij me rastin e aplikimit në tender dhe për këtë AK ka kërkuar sqarime, me çrast OE i rekomanduar e ka sjellur raportin në fjalë i cili përmban datën para publikimi për kontratë por kjo datë sipas nenit të lartcekur duhet të verifikohet në mënyrë efektive, dhe për ta vërtetuar në mënyrë efektive atëherë AK duhet të kryej një kontroll efektiv konform nenit 52, paragrafit 7 të LPP.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar haromoni me dispozitat e LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike

për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**
- OE - **N.N.P. " ATC COM " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: